

**VENDIM**  
**Nr. 6, datë 16.1.2023**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS NR. 417, SERIA T18, SË SHOQËRISË “RENRGY TRADING GROUP” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, si dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3, si dhe nenit 16, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.1.2023, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1/1 prot., datë 12.1.2023, “Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës nr. 417, seria T18, të shoqërisë ‘ReNRGY Trading Group’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 163, datë 19.7.2018”,

konstatoi se:

- Shoqëria “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1 prot., datë 4.1.2023, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në nenin 16, pika 1, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, përcaktohet se, paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë (data e përfundimit të licencës nr. 417, seria T18, është 19.7.2023).

Sikurse konstatohet shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj më datë 4.1.2023, pra brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1 të rregullores.

- Në zbatim të përcaktimeve të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar; aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin e plotësuar të aplikimit, sipas shtojcës 1; çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë; informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë së licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur).

- Neni 16, germa “a”. Formatin e plotësuar të aplikimit, sipas shtojcës 1.

- Neni 9, pika 1, germa “a”, plotësuar.

- Neni 16, germa “b”, plotësuar.

- Neni 16, germa “c”, plotësuar.

- Në këtë aplikim konstatohet mungesa e dokumentacionit/informacionit si vijon:

- Neni 16, germa “a”. Formatin e plotësuar të aplikimit, sipas shtojcës 1.

- Neni 9, pika , germa “b”. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE të dhënat sipas kërkesave respektive të formatit të ri të aplikimit.

- Neni 9, pika, germa “c”. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE të dhënat sipas kërkesave respektive të formatit të ri të aplikimit.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të aneksit A të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Shoqëria ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

- Për dokumentacionin e munguar, do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.

- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 417, seria T18, të shoqërisë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 20.7.2023.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
**Petrit Ahmeti**